



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 621/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.08.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me objekt: “*Blerje materiale pastrimi dhe detergjente, për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë*”, me nr. REF-19604-07-05-2017, me fond limit 1,513,500 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 17.07.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Rrogozhinë.

Ankimues: Operatori ekonomik “MIQESIA” sh.p.k..
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 1 (Pranë Epta Company), Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Rrogozhinë.
Adresa: Lagjia Nr.1, Rruga Kavajës, Rrogozhinë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Rrethanat e çështjes



II.1. Në datën 06.07.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me objekt: “Blerje materiale pastrimi dhe detergjente, për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë”, me nr. REF-19604-07-05-2017, me fond limit 1,513,500 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 17.07.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Rrogozhinë.

II.2. Në datën 11..2017, operatori ekonomik ankimues “MIQESIA” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme e konkretisht:

[...]Ne DST pika 2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 7 pika 1), leje tregtimi ose license të leshuar nga organet përkatëse mbështetur në legjislacionin në fuqi për prodhimin dhe tregtimin e mallrave objekt prokurimi.

Kjo pike është e paqarte për operatorët ekonomik pasi që operatori ekonomik e ka në veprimtarin e tij objektin e prokurimit ju lutem modifikoni pikën si më poshtë:

2.1 Objekti i Prokurimit duhet të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik

a.Nje deklarate per gjendjen financiare nga nje ose me shume banka, ku të përcaktohet që operatori ekonomik pjesëmarrës ka burime të mjaftueshme për realizimin e kontratës 10% te fondit limit leshuar jo me pare se 5 dite para dates se hapjes se ofertave.

Pra ne piken 5 te Nenit 27 per te provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare nuk eshte e parashikuar te kerkohet qe operatori te paraqese nje deklarate te gjendjes financiare nga nje ose me shume banka sa 10% e vleres se kontrates qe prokurohet. Duke qene se ne Rregulloren e Prokurimit Publik nuk eshte e parashikuar nje kerkese e tille, ne kerkojme heqjen e kesaj pike.

d. Vertetim nga Bashkia rogozhine qe konfirmon se, operatori ekonomik nuk ka detyrime kundrejt Bashkise dhe njesive Administrative ne varesi te saj. Ky dokument, duhet te jete leshuar, gjate periudhes qe nga momenti i shpalljes se procedures se prokurimit ne Sistemin elektronik te prokurimeve publike ne faqen www.app.gov.al. Per kete te paraqitet nje kerkese me shkrim, nga administratori i shoqerise ku cdo ofertues do te pajiset me dokumentacionin perkates.

Ne EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGETAR PER TE DHENAT E SUBJEKTIT "SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR" tregohen dhe selit e operatoreve ekonomik nese ne Ekstraktet e QKB shikohet seli ne Rrogozhine, do ishte e drejte te kerkohet nje vertetim qe ska detyrime ndaj jush. Taksat vendore, gjobat e ndryshme nga institucionet audituese legjitime etj ne i kemi selin ne Tirane. Persa i perket Vertetimit sjemi aspak te detyruar te marrim nje vertetim nga ju,persa kohe jemi me seli vetem ne Tirane. [...]"

II.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit te administruar pranë KPP, si dhe referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, autoriteti kontraktor nuk ka kthyer përgjigje lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur pranë tij nga pala ankimuese.

II.4. Në datën 25.07.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Në datën 03.08.2017, nëpërmjet shkresës me nr.2690prot., datë 01.08.2017, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik "MIQESIA" sh.p.k.

II.5.1 Nga verifikimet të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet se autoriteti kontraktor ka vijuar me procedurën e prokurimit objekt ankimi, ka kryer vlerësimin në datën 20.07.2017 dhe ka njoftuar fituesin në datën 28.07.2017.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: “[...]Ne DST pika 2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë: Sipas shtojces 7 pika 1), leje tregëtimi ose license te leshuar nga organet përkatëse mbështetur në legjislacionin ne fuqi per prodhimin dhe tregtimin e mallrave objekt prokurimi.Kjo pike eshte e paqarte per operatoret ekonomik pasi qe operatori ekonomik e ka ne veprimtarin e tij objektin e prokurimit ju lutem modifikoni piken si me poshte:[...]” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në dokumentat e tenderit shtojca 7, pika 2.1, “Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë”, nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

“Sipas shtojces 7 pika 1), leje tregëtimi ose license te leshuar nga organet përkatëse, mbështetur në legjislacionin ne fuqi, per prodhimin dhe tregtimin e mallrave objekt prokurimi.”.

III.1.2.Në nenin 46 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese[...].”

III.1.3.Lidhur me kriterin e sipërcituar, të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, referuar ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, si dhe mallrave objekt prokurimi të kërkuara nga autoriteti kontraktor në shtojcën 10 të dokumentave standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, KPP konstaton se në asnjë rast nuk egziston detyrimi ligjor për pajisje me leje ose licence për tregtimin e produkteve “materiale pastrimi”, të cilat janë objekt prokurimi. Ndërsa lidhur me referimin që ka bërë autoriteti kontraktor në kriterin e sipërcituar “Sipas shtojcës 7 pika 1”, në të cilin përcaktohet se: “Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):a) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv); b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP; c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional. Kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës Nr. 8 “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore”. Në rastin kur kandidati/ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, në vend të Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, do të paraqitet vendimi i Gjykatës për regjistrimin si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë

07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se ky referim nuk i orienton operatorët ekonomik të interesuar mbi mënyrën ose dokumentacionin që duhet paraqitur në përmbushje të kriterit të vendosur, por shkakton konfuzion dhe paqartësi. KPP gjykon se autoritetet kontraktore, në dokumentat standarte të tenderit duhet të vendosin kriteret të bazuara në akte ligjore dhe nënligjore në fuqi, të kuptueshme për operatorët ekonomik të interesuar, në proporcion me volumet e kontratës që prokurohet, jo diskriminuese, si dhe duhet të përcaktojnë dokumentacionin konkret me anë të të cilit duhet të përmbushet kriteri i sipërcituar në kuptim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 28 “Kontratat e shërbimeve”, pika 2 ku përcaktohet se: ***Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Në këto kushte, autoriteti kontraktor duhet të bëjë rishikimin dhe qartësimin e kriterit të sipërcituar.***

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se “[...]a.Nje deklaratë për gjendjen financiare nga një ose me shumë banka, ku të përcaktohet që operatori ekonomik pjesëmarrës ka burime të mjaftueshme për realizimin e kontratës 10% të fondit limit leshuar jo më parë se 5 ditë para datës së hapjes së ofertave. Pra në pikën 5 të Nenit 27 për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare nuk është e parashikuar të kërkohej që operatori të paraqesë një deklaratë të gjendjes financiare nga një ose me shumë banka sa 10% e vlerës së kontratës që prokurohet. Duke qenë se në Rregulloren e Prokurimit Publik nuk është e parashikuar një kërkesë e tillë, ne kërkojmë heqjen e kësaj pike. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 7 pika 2.2 gërma a, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, nga autoriteti kontraktor është kërkuar: “Nje deklaratë për gjendjen financiare nga një ose me shumë banka, ku të përcaktohet që operatori ekonomik pjesëmarrës ka burime të mjaftueshme për realizimin e kontratës 10% të fondit limit leshuar jo më parë se 5 ditë para datës së hapjes së ofertave)”

III.2.2. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese, gërma c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilanci, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë,

të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur.” Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”

III.2.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike e organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet ekonomike dhe financiare, në përputhje dhe në përjestim me volumin e kontratës objekt prokurimi, në mënyrë që të krijojë bindjen dhe sigurinë për realizimin me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se vendosja e kërkesës mbi paraqitjen e një deklarate për gjëndjen financiare të ofertuesve e cila të jetë lëshuar jo më parë se 5 ditë nga data e hapjes së ofertave është në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se “[...]d. Vertetim nga Bashkia rogozhine që konfirmon se, operatori ekonomik nuk ka detyrime kundrejt Bashkise dhe njesive Administrative ne varesi te saj. Ky dokument, duhet te jete leshuar, gjate periudhes qe nga momenti i shpalljes se procedures se prokurimit ne Sistemin elektronik te prokurimeve publike ne faqen ëëë.app.gov.al. Per kete te paraqitet nje kerkese me shkrim, nga administratori i shoqerise ku cdo ofertues do te pajiset me dokumentacionin perkates. Ne EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGETAR PER TE DHENAT E SUBJEKTIT ”SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR” tregohen dhe selit e operatoreve ekonomik nese ne Ekstraktet e QKB shikohet seli ne Rrogozhine, do ishte e drejte te kerkohet nje vertetim qe ska detyrime ndaj jush. Taksat vendore, gjobat e ndryshme nga institucionet audituese legjitime etj ne i kemi selin ne Tirane. Persa i perket Vertetimit sjemi aspak te detyruar te marrim nje vertetim nga ju,persa kohe jemi me seli vetem ne Tirane. [...]” , Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1.Në dokumentat e tenderit, shtojca 7 pika 2.2 gërma d, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, nga autoriteti kontraktor është kërkuar: ”Vertetim nga Bashkia Rrogozhine që konfirmon se, operatori ekonomik nuk ka detyrime kundrejt Bashkise dhe njesive Administrative ne varesi te saj.Ky dokument, duhet te jete leshuar gjate periudhes, qe nga momenti i shpalljes se procedures se prokurimit ne sistemin elektronik te prokurimeve publike ne faqen ëëë.app.gov.al.

Per kete, te paraqitet nje kerkese me shkrim, nga administratori i shoqerise, ku cdo ofertues do te pajiset me dokumentacionin perkates.

(Çdo anetar i bashkimit te operatoreve ekonomik, duhet te paraqese kete dokument/vertetim). ”

III.3.2. Në nenin 12, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të 29 ndryshuar parashikohet se “Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit, në përputhje me ligjin e posaçëm. 2. Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. taksapaguesi regjistron çdo vendndodhje të biznesit pranë bashkisë ose komunës përkatëse.

III.3.3. Nga interpretimi i nenit 12 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, KPP konstaton se marrëdhëniet juridike dhe njëherazi detyrimet, mes një subjekti juridik privat dhe njësisë të qeverisjes vendore, lindin vetëm në momentin kur subjekti juridik ushtron veprimtari pranë territorit të njësisë administrative. Nga ky moment juridik, rrjedh njëherazi dhe e drejta e njësisë administrative për vjeljen e taksave respektive dhe lëshimit të vërtetimit ndaj subjektit nëse ka shlyer të gjithë detyrimet. K.P.P. gjykon se për vetë pozitën e dhënë nga ligji, autoriteti kontraktor mund të kryejë verifikimet përkatëse në rast se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedura prokurimi kanë ose jo detyrime financiare ndaj autoritetit kontraktor. Gjithashtu, KPP vlerëson të thekosjë se, operatorët ekonomik duhet të kenë shlyer detyrimet për taksat vendore për të gjitha vendet ku kryejnë aktivitetin e tyre tregtar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KPP konstaton autoriteti kontraktor ka vijuar me procedurën e prokurimit objekt ankimi, ka kryer vlerësimin në datën 20.07.2017 dhe ka njoftuar fituesin në datën 28.07.2017.

III.4.1. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, dhe 1.1. dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar:

“Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”

“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.””.

III.4.2 Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi

është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

III.4.3. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

III.4.4. KPP konstaton, se autoriteti kontraktor ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt ankimi duke pranuar ofertat nga ana e operatorëve ekonomikë, si dhe duke shpallur fituesin, gjatë periudhës kohore ku operatorëve ekonomikë të cilët kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor i lind e drejta e ankimimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Në këto kushte, KPP gjykon se në respekt të nenit 64 pika 3 gërma ‘ç’ të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në të cilin parashikohet se “ Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik160, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë: a) ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.”, si dhe për të mbrojtur interesin e ligjshëm të operatorëve ekonomikë ankimues nga njëra anë dhe interesin publik nga ana tjetër, autoriteti kontraktor duhet të anultojë procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi për shkak të shkeljeve të mësipërme procedurale.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranohet pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik „MIQESIA” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me objekt: “Blerje materiale pastrimi dhe detergjente, për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë”, me nr. REF-19604-07-05-2017, me fond limit 1,513,500 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 17.07.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Rrogozhinë.
2. Autoriteti kontraktor të anultojë procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Në rishpalljen e procedurës së prokurimit autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “MIQESIA” sh.p.k.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1330 Protokoli, Datë 25.07.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Kryetar
Evis Shurdha

